



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. prot.

Tiranë, më 14.06.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

Z. B' Ç
"QENDRA PËR GAZETARI CILËSORE"
Të dhëna kontakti, e-mail:

I nderuar z. Ç

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar në datë 9.6.2022 protokolluar me tonën nr. prot., datë 10.6.2022, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Nevoja për zgjatjen e afatit kushtetues, kishte të bëntë me përnbylljen e plotë të rivlerësimit kalimtar për 805 subjekte në total, pasi deri ditën kur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi me votë zgjatjen e mandatit të organeve të vettingut, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kish rivlerësuar mbi 60% të subjekteve ex officio.

Në lidhje me pyetjen e dytë, ju informojmë se fondet buxhetore për Komisionit e Pavarur të Kualifikimit akordohen çdo vit me ligjin vjetor "Për Buxhetin e Shtetit", ku KPK ka një zë më vete krahas institucioneve të tjera të rivlerësimit kalimtar. Informacionin për buxhetin vjetor e gjeni në faqen zyrtare përmes këtij linku <https://kpk.al/buxheti/>.

Komisioni i publikon ato në kategorinë e programit të transparencës në faqën e tij zyrtare, si detyrim që buron nga ligji për të drejtën e informimit.

Në lidhje me pyetjen e tretë ju informojmë se, Komisioni gëzon të gjitha garancitë ligjore e kushtetuese për të përfunduar të plotë procesin e nisur në qershor të vitit 2017. Këto garanci janë konfirmuar edhe nga Komisioni i Venecias në opinionin e tij dërguar Kuvendit të Shqipërisë, përpara votimit për zgjatjen e mandatit kushtetues të KPK-së dhe IKP-së. Aktualisht procesi i rivlerësimit vijon dhe deri në 31 dhjetor 2024 do të jetë përnbyllur vetingu i të 805 subjekteve të shortuar. Statistikat për numrin e subjekteve të përfunduara nga Komisioni i gjeni të përditësuar periodikisht në faqen zyrtare kpk.al.

Duke ju falënderuar, ju urojmë punë të mirë.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM
Edmond Verçani

